DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-539/8
Data. Datum Date. 24.07.2023

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>**Milaim Hajdari**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Trim Berisha** , Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani**, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 14.07.2023 VI-020-539 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Vjosa Ahmetaj**, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| **Vendimi 02 Nr. 030101-31030/23 për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal** |
|---|
| I miratuar më datë: 29.06.2023 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.06.2023 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

**Arsyetim**

Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2023, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 030101-31030/23 për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, është bazuar në nenin 11, 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndër komunal.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gllogocit me datë 29.06.2023, është miratuar më 30 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit kur të përgatitet Marrëveshja fushat duhet të jenë të specifikuara ashtu siç e parasheh legjislacioni në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me ketë vlerësim.

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-539/18
-VI-
Data. Datum. Date. 24.07.2023

Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit të Pushtetit Lokal*

*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*

*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Ramiz Lladrovci,** gradonačenik opštine Glogovac<br>**Milaim Hajdari,** predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Kopija: | Jedinici za adminstraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za adminstraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elber Krasniqi, ministar MALS-a**<br>**Trim Berisha,** zamenik generalnog sekretara MALS-a | |
| Od: | **Besim Myrtezani,** zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština | Dana, 14.07.2023. Br.VI-020-539 |
| Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:<br><br>Službenik-ca za izradu prave procene: | **Xhevat Tafa,** rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

| |
|---|
| **Odluka 02 br. 030101-31030/23 za pristupanje u međuopštinsku saradnju** |
| Usvojena dana, 29.06.2023. |
| Podnošena na razmatraje u MALS-u dana, 30.06.2023. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu ***u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.***

**Obrazloženje**

Skupština opštine Glogovac, na sednici održanoj dana, 29.06.2023. godine, usvojila je **Odluku 02 br. 030101-31030/23 za pristupanje u međuopštinsku saradnju.**

MALS, konstatuje da odluka doneta od strane Skupštine opštine Glogovac, zasnovana je na članu 11 i 12. tačka (d) članu 40 tačka (j) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 15. Stav 2 Zakona br. 04/L-010 o o međuopštinskoj saradnji.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opština Glogovac dana, 29.06.23. godine, sa 30 glasova "za", 0 "protiv" i 0 "udržanih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, traži od Skupštine opštine Glogovac, da nakon izrade sporazuma, oblasti treba da se specifikuju kao što je predviđeno sa zakonodavstvom na snazi.

Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**Vjosa Ahmetaj**

**From:** Blerta Halimi
**Sent:** 13 July 2023 15:08
**To:** Vjosa Ahmetaj
**Cc:** Flurim Arifi; Vjosa Shehu
**Subject:** FW: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Te nderuar,

Nisma per bashkepunim nderkomunal e komunes se Drenasit eshte ne rregull, por kur te pergatitet Marreveshja fushat duhet te jene te specifikuara ashtu sic e parasheh Ligji.

**Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal - Bashkëpunimi ndërkomunal është i bazuar në:**

1.1. interesin e përbashkët lokal;
1.2. ushtrimin e një ose më shumë kompetencave vetanake ose të zgjeruara të komunave;
1.3. vullnetin e lirë të komunave për të krijuar marrëdhënie të bashkëpunimit ndër-komunal;
1.4. ndarjen e roleve dhe përgjegjësive midis komunave dhe bashkimin e resurseve komunale për nevojat e bashkëpunimit;
1.5. përmirësimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale në dobi të qytetarëve.

**Qëllimet e Bashkëpunimit Ndërkomunal (BNK) janë:**

- Përfitimi i njohurive, shkëmbimi i përvojave dhe inovacioni;
- Lidhja e komunave në maksimalizimi e mundësive të ofrimit të shërbimeve për të përmbushur nevojat e përbashkëta të komunitetit;
- Ulja e kostove përmes eliminimit të dyfishimit;
- Qasja në shkallën e ekonomisë;
- Zhvillimi i platformave efektive lokale për të arritur rezultate më të mira të qeverisjes për komunitetin.

**Fushat e Bashkëpunimit Ndërkomunal (BNK) janë:**
- Zhvillimi socio-ekonomik lokal dhe rajonal;
- Zhvillimi dhe shfrytëzimi i tokës;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Promovimi dhe zhvillimi i turizmit;
- Promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;
- Zhvillimi i infrastrukturës ndër-komunale;
- Kompetencat tjera vetanake.

Me respekt,

**From:** Vjosa Shehu
**Sent:** Thursday, July 6, 2023 10:33 AM
**To:** Vjosa Ahmetaj

**Cc:** Jeton Qela; Xhevat Tafa; Flurim Arifi; Blerta Halimi
**Subject:** Re: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Vjosa,

Fillimisht kur te dergohet nje Vendim nga ana e komunes ne kete rast sic eshte rasti me BNK te pakten nje Vendim i derguar nga Komuna duhet te kete te dhena bazike dhe jo vetem te shkruhet ne pergjithesi se cfare ka nevoje komuna e Zvecanit, pasi qe ne nuk mundemi qe te dijme sakte se cfare bashkepunimi po kerkojne te bejne pa qene specifik/konkret.

- Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal duhet të përmbajë qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, komunat e përfshira në bashkëpunim, formën e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi, si dhe çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal.

Andaj, ne nuk mundemi si Divizion i BNK-se te bejme vleresimin pa e pranuar Vendimim/Nismen me te pakten 5 nene!

Sdq, nese ka kohe ende per konfirmim kur te vie nga pushim vjetor Udheheqejsja e Divizionit (te Hanen) miret me kete ceshtje.

Faleminderit shume per mirekuptim!

Vjosa

---

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** Thursday, July 6, 2023 10:01 AM
**To:** Vjosa Shehu
**Cc:** Jeton Qela; Xhevat Tafa; Flurim Arifi; Blerta Halimi
**Subject:** RE: Për vlerësim të ligjshmërisë......

E nderuar,

Ju lutem të bëni vlerësimin e përmbajtjes së Vendimit nëse është në pajtim me legjislacionin, sepse forma e vendimit është teknikë e Komunës që nuk na intereson.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj

**From:** Vjosa Shehu
**Sent:** 06 July 2023 09:20
**To:** Vjosa Ahmetaj
**Cc:** Flurim Arifi; Blerta Halimi
**Subject:** Re: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Pershendetje Vjosa,

Sa I perket vendimit te derguar nga Komuna e Drenasit per te hyre ne bashkepunim nderkomunal me komunen e Zvecanit, vendimi I derguar qenka vetem si njoftim nga ana e komunes, andaj ju lutem vendimi per Iniciative duhet te jete ne kete form te bashkengjitur.

Faleminderit dhe pune te mbare,
Vjosa

---

**From:** Blerta Halimi
**Sent:** Thursday, July 6, 2023 9:04 AM
**To:** Vjosa Shehu
**Subject:** Fwd: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Miremengjesi Vjosa,

Te lutem shiko kete vendim me departamentin ligjor!

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

> **From:** Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>
> **Date:** July 3, 2023 at 11:28:04 GMT+2
> **To:** Blerta Halimi <blerta.halimi@rks-gov.net>
> **Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
> **Subject: Për vlerësim të ligjshmërisë......**
>
> E nderuar,
>
> Bashkangjitur gjeni **Vendimin 02 Nr. 030101-31030 për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal të KK Gllogoc**, për vlerësim të ligjshmërisë.
>
> Me respekt,
> Vjosa Ahmetaj

**Vjosa Ahmetaj**

| | |
|---|---|
| **From:** | Vjosa Shehu |
| **Sent:** | 06 July 2023 10:33 |
| **To:** | Vjosa Ahmetaj |
| **Cc:** | Jeton Qela; Xhevat Tafa; Flurim Arifi; Blerta Halimi |
| **Subject:** | Re: Për vlerësim të ligjshmërisë...... |

Vjosa,

Fillimisht kur te dergohet nje Vendim nga ana e komunes ne kete rast sic eshte rasti me BNK te pakten nje Vendim i derguar nga Komuna duhet te kete te dhena bazike dhe jo vetem te shkruhet ne pergjithesi se cfare ka nevoje komuna e Zvecanit, pasi qe ne nuk mundemi qe te dijme sakte se cfare bashkepunimi po kerkojne te bejne pa qene specifik/konkret.

- Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal duhet të përmbajë qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, komunat e përfshira në bashkëpunim, formën e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi, si dhe çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal.

Andaj, ne nuk mundemi si Divizion i BNK-se te bejme vleresimin pa e pranuar Vendimim/Nismen me te pakten 5 nene!

Sdq, nese ka kohe ende per konfirmim kur te vie nga pushim vjetor Udheheqejsja e Divizionit (te Hanen) miret me kete ceshtje.

Faleminderit shume per mirekuptim!

Vjosa

---

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** Thursday, July 6, 2023 10:01 AM
**To:** Vjosa Shehu
**Cc:** Jeton Qela; Xhevat Tafa; Flurim Arifi; Blerta Halimi
**Subject:** RE: Për vlerësim të ligjshmërisë......

E nderuar,

Ju lutem të bëni vlerësimin e përmbajtjes së Vendimit nëse është në pajtim me legjislacionin, sepse forma e vendimit është teknikë e Komunës që nuk na intereson.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj

**From:** Vjosa Shehu
**Sent:** 06 July 2023 09:20
**To:** Vjosa Ahmetaj

**Cc:** Flurim Arifi; Blerta Halimi
**Subject:** Re: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Pershendetje Vjosa,

Sa I perket vendimit te derguar nga Komuna e Drenasit per te hyre ne bashkepunim nderkomunal me komunen e Zvecanit, vendimi I derguar qenka vetem si njoftim nga ana e komunes, andaj ju lutem vendimi per Iniciative duhet te jete ne kete form te bashkengjitur.

Faleminderit dhe pune te mbare,
Vjosa

---

**From:** Blerta Halimi
**Sent:** Thursday, July 6, 2023 9:04 AM
**To:** Vjosa Shehu
**Subject:** Fwd: Për vlerësim të ligjshmërisë......

Miremengjesi Vjosa,

Te lutem shiko kete vendim me departamentin ligjor!

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

> **From:** Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>
> **Date:** July 3, 2023 at 11:28:04 GMT+2
> **To:** Blerta Halimi <blerta.halimi@rks-gov.net>
> **Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
> **Subject: Për vlerësim të ligjshmërisë......**
>
> E nderuar,
>
> Bashkangjitur gjeni **Vendimin 02 Nr. 030101-31030** për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal **të KK Gllogoc**, për vlerësim të ligjshmërisë.
>
> Me respekt,
> Vjosa Ahmetaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit (Gllogoc)**
Kuvendi Komunal
02 Nr.030101-31030 dt. 29/06/2023

Data / Datum / Date: 30.06.2023
-01- 020-539

Bazuar në nenin 11, neni 12, pika d), nenit 40, pika j) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, dhe ne zbatim të nenit 15, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-010, për Bashkëpunim ndër komunal, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: **29.06.2023** miratoi këtë:

# VENDIM

**Për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal**

**I.**

Me këtë Vendim, mandatohet Komuna e Gllogocit në ushtrimin e disa kompetencave me theks të veçantë: Buxhet, Financa dhe Administratë të Përgjithshme, Fushën e Prokurimit, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe fusha tjera varësisht nga nevojat e Komunës së Zveçanit.

**II.**

Autorizohet kryetari i komunës në përgatitjen e marrëveshjes për bashkëpunim në koordinim me komunën e Zveçanit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesave të kësaj komune.

**III.**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Milaim Hajdari**

Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

## ARSYETIM

Komuna e Zveçanit ka kërkuar nga komuna e Gllogocit që të mandatohet për ushtrimin e disa kompetencave sipas kërkesës se komunës së Zveçanit.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, është prezantuar para anëtarëve të Kuvendit të Drenasit ky propozim vendim pasi që ky bashkëpunim është normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Bashkëpunim ndër komunal si dhe aktet tjera për zbatimin e këtij ligji.

Për realizimin e qëllimeve dhe interesit të Komunës se Zveçanit lidhur me mandatimin e Komunës së Gllogocit në ushtrimin e disa kompetencave dhe përgjegjësive të caktuara në të mirë dhe interesit të qytetarëve të kësaj komune, komuna e Zveçanit ka mungesë të stafit adekuat për kryerjen e shërbimeve të caktuara e si rezultat i kësaj mungese një pjesë e shërbimeve jetike komunale nuk po arrijnë të përfundohen.

Ky bashkëpunim do të jetë në pajtim me parimet, format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Bashkëpunimi me komunën e Zveçanit, është në funksion të interesit të qytetarëve të kësaj komune, andaj, kërkohet që i njëjti të aprovohet.